



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.138

19 tetor

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9814 datë 4.10.2007	Për një ndryshim në ligjin nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”	3799
Vendim i Kuvendit nr.124, datë 8.10.2007	Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës.....	3799
Vendim i Kuvendit nr.125, datë 8.10.2007	Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin e procedurave të tenderimit të rrugës Durrës – Morinë	3800
Vendim i Kuvendit nr.126, datë 8.10.2007	Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim	3801
Vendim i Kuvendit nr.127, datë 8.10.2007	Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin e objektit dhe procedurave të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim.....	3801
Vendim i Kuvendit nr.128, datë 11.10.2007	Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për hetimin “Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave”	3802

LIGJ
Nr.9814, datë 4.10.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8788, DATË 7.5.2001 “PËR ORGANIZATAT
JOFITIMPRURËSE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SE SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

Lehtësimi dhe përjashtimi nga detyrimet fiskale

Organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga format e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, që realizojnë nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë.

Të ardhurat e realizuara duhet të destinohen për veprimtari, për të cilat organizata është regjistruar, në rast të kundërt, veprimtaria vlerësohet fitimprurëse dhe i nënshtrohet tatimit.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5491, datë 10.10.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.124, datë 8.10.2007

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR ZBATIMIN E LIGJIT
TË KONCESIONEVE, DHËNIEN ME KONCESION TË OBJEKTEVE TË NDRYSHME NË
PRONËSI SHTETËRORE, KUSHTET E DHËNIES SË KËTYRE KONTRATAVE PËR
PERIUDHËN 2001 E NË VIJIM DHE PROCEDURAT PËR FILLIMIN E PUNIMEVE PËR
NDËRTIMIN E TEC-IT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të neneve 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës.

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt dhe detyrë të hetojë zbatimin e ligjit të koncesioneve, dhënien me koncesion të objekteve të ndryshme në pronësi shtetërore, si dhe kushtet e dhënies së këtyre kontratave për periudhën 2001 e në vijim dhe procedurat për fillimin e punimeve për ndërtimin e TEC-it të Vlorës.

III. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga shumica parlamentare dhe 5 nga opozita. Kryesia e Komisionit, në bazë të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i takon Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej 3 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij Komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.125, datë 8.10.2007

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E
PROCEDURAVE TË TENDERIMIT TË RRUGËS DURRËS - MORINË**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të neneve 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar i Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e procedurave të tenderimit të rrugës Durrës-Morinë.

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt të punës së tij hetimin e procedurave të tenderimit të rrugës Durrës-Morinë.

III. Komisioni Hetimor Parlamentar përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga shumica parlamentare dhe 5 nga opozita. Kryesia e Komisionit, në bazë të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i takon Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej 3 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij Komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.126, datë 8.10.2007

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT NË DISPOZICION TË MINISTRIVE, INSTITUCIONEVE KRYESORE TË VARËSISË DHE NDËRMARRJEVE PUBLIKE NËPËRMJET PROKURIMEVE PUBLIKE PËR PERIUdhËN 2001 E NË VIJIM

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të neneve 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e shpenzimeve të Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim.

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt dhe detyrë të hetojë shpenzimet e Buxhetit të Shtetit në dispozicion të ministrive, institucioneve kryesore të varësisë dhe ndërmarrjeve publike nëpërmjet prokurimeve publike për periudhën 2001 e në vijim.

III. Komisioni përbëhet nga 13 anëtarë, 7 nga shumica parlamentare dhe 6 nga opozita. Kryesia e Komisionit, në bazë të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i takon Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej 4 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij Komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.127, datë 8.10.2007

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN E OBJEKTIT DHE PROCEDURAVE TË KONTRATËS SË PRIVATIZIMIT TË ALBTELEKOMIT PËR PERIUdhËN 2001 E NË VIJIM

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të neneve 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002

“Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin e objektit dhe procedurave të nënshkrimit të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim.

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt dhe detyrë të hetojë objektin dhe procedurat e nënshkrimit të kontratës së privatizimit të Albtelekomit për periudhën 2001 e në vijim.

III. Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë, 6 nga shumica parlamentare dhe 5 nga opozita. Kryesia e Komisionit, në bazë të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i takon Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej 3 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij Komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM
Nr.128, datë 11.10.2007**

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR HETIMIN
“MBI PËRGJIMET E PALIGJSHME TË TELEFONAVE”**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës, të neneve 8 e 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokristiane,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për hetimin “Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave”.

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt dhe detyrë zbardhjen e plotë të motiveve, arsyeve dhe bazës ligjore në nismën e ndërmarrë (nga struktura të caktuara) për përgjimin e telefonave të deputetëve nga ana e strukturave të veçanta, kryesisht të Ministrisë së Brendshme.

III. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, 5 nga shumica parlamentare dhe 4 nga opozita. Kryesia e Komisionit, në bazë të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, i takon Grupit Parlamentar të Partisë Demokristiane.

IV. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat prej 3 muajsh nga data e miratimit të këtij vendimi.

V. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të këtij Komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA

(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 17.10.2007
Doli nga shtypi më 19.10.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 8 lekë